REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 540/26 Dt. 17.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet ftesa drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, për pjesëmarrje në Mëngjesin e 75-të Kombëtar të Lutjes në Uashington D.C në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që organizohen me 3 shkurt 2027 deri me 4 shkurt 2027.

2. Miratohet ftesa zyrtare e Organizatës "Tech For Good" drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, për pjesëmarrje në takime dhe diskutime në lidhje me një bashkëpunim të mundshëm ndërkombëtar në kuadër të iniciativës së granteve, qytetet ofrojnë: Zgjidhje të IA për shërbime publike të mbështetur nga Fondacioni Open AI dhe Fondacioni Rockefeller. Takimet do të mbahen nga data 7 shkurt 2027 deri me 12 shkurt 2027 në Miami, Florida në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3. Në takimet e cekura si në këtë vendim, do të marrë pjesë edhe Islam Ukaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

4. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 01 shkurt 2027 dhe kthimi me 13 shkurt 2027, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, të akomodimit, ushqimit, për pagesë të mëditjeve, si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit, për dy takimet.

5. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

6. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Kabinetit të Kryetarit,
- Arkivës së Kryetarit.